

DEKRET
Nr. 448, datë 5.12.2025

PËR DHËNIE DEKORATE

Në mbështetje të nenit 92, germa “ç”, nenit 93 të Kushtetutës, nenit 6, pika 1, të ligjit nr. 93/2022, “Për dekoratat në Republikën e Shqipërisë”, me propozim të Kryeministrit,

DEKRETOJ:

Neni 1

**Dhënien e dekoratës “Oficer i Urdhrit Suprem të Shqiponjës”
zotit Tedi Papavrami**

“Në vlerësim të meritave të veçanta, të shquara e të qëndrueshme në fushën e artit dhe të kontributeve në rrezatimin ndërkombëtar të kulturës, letrave dhe emrit shqiptar, si një nga instrumentistët më të talentuar dhe profesionalisht më të përsosur të brezit të tij, performanca artistike e të cilit ka shenjuar sallat më prestigjioze dhe publikun artdashës në Shqipëri dhe kudo në botë, duke merituar admirimin, respektin dhe mirënjohjen e të gjithëve”.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENT I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj